



Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBAL

Mbledhja e rregullt e **Komitetit për Politikë dhe Financa (KPF)**, e mbajtur më **18 maj 2026, (e hënë)**, me fillim në orën **10:10**. Mbledhjen e kryesoi Kryesuesi i Kuvendit, **z. Fatmir Iska**.

Kryesuesi: Fillimisht, besoj që materialin e keni pranuar me kohë! Atëherë, përshëndetje për të gjithë! I nderuar nënkryetar i komunës, të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa, drejtorë të drejtorive, zyrtarë komunalë, përfaqësues të OSBE-së, kabinetin e kryetarit, sekretarinë e kuvendit dhe kryesuesen e Komitetit për Komunitete. E hapim mbledhjen e **katërt (4)** për këtë vit kalendarik. Në konsultim me kryetarin e komunës kemi përgatitur këtë:

R E N D I T E

- 1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza, 2025-2031;**
- 3. Shqyrtimi i Planit të Punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2026;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi: Të nderuar anëtarë të KPF-së, ky është rendi i ditës për sot me 4 pika. Nëse dikush ka diçka rreth rendit të ditës? Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash aprovohet rendi i ditës për sot.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit nga mbledhja e kaluar:

Kryesuesi: Nëse dikush ka diçka rreth procesverbalit nga mbledhja e kaluar?... Nëse jo, atëherë po e vendosim në votim. Kush është “për”?... Kundër?... Abstenim?... Me shumicë votash aprovohet pika e parë e rendit të ditës.

2. Shqyrtimi i vendimit për miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Ujërave të Zeza, 2025-2031:

Përparim Krasniqi: Faleminderit, kryesues! Të nderuar anëtarë të KPF-së, monitorues nga LMT dhe ju të pranishëm. Ky dokument është pjesë e një projekti në bashkëfinancim me Bashkimin Evropian me Haraçinë. Ky projekt është pjesë e strategjisë, është hartuar nga zyrtarë të BE-së, si dhe pjesëmarrës ka qenë edhe GIZ-i gjerman. Komuna e Rahovecit e ka krijuar grupin punues, i cili e ka shqyrtuar këtë dokument me të gjitha hapat ligjorë. Ky dokument përmban gjendjen faktike, infrastrukturën publike, mbrojtjen e mjedisit, si dhe konsultimet publike që janë realizuar me qytetarë. Në mbledhjen e rregullt të kuvendit, do të jetë i pranishëm grupi punues i këtij dokumenti të rëndësishëm.

Defrim Kafexhiu: Faleminderit, kryesues! Përshëndetje për të gjithë! Drejtor, a është e përfshirë në këtë strategji mënyra se si do të bëhet zgjidhja e problemeve të kyçjes në rrjetet e kanalizimeve për shtëpitë (zonat) që nuk janë të kyçura? Gjithashtu, është mirë të na tregoni saktë se sa përqind e banorëve nuk janë të kyçur në rrjetin e kanalizimit dhe a është e përfshirë këtu në strategji?

Përparim Krasniqi: Defrim, 95 % e qytetarëve kanë çasje në kanalizim dhe vetëm 5% nuk kanë çasje, për shkak të problematikave të problemeve pronësore. E dimë këtë problematikë, në rrugën “Vëllezërit Frashëri” janë dy

probleme dhe kësaj periudhe po tentojmë t'i zgjidhim dhe në një të ardhëm të afërt si komunë të kemi 99% të banorëve çasje në ujëra të zeza. Janë të paraparë kolektorë të ujërave të zeza dhe gropa septike, duke përfshirë impiantin e madh që do të ndahet në 4 pjesë, një zonë urbane dhe tri zona të tjera.

Defrim Kafexhiu: Drejtor, shtëpitë e banimit që ndërtohen pa leje (nëse janë të banueshme), a e ka obligim që komuna t'ju sigurojë kyçjen në rrjetin e kanalizimit?

Përparim Krasniqi: Komuna nuk jep leje për kanalizim, pa leje nga drejtoria e Urbanizmit që i jep për shtëpi. Nuk ka çasje të kanalizimit pa leje. Ne po flasim për rrjete kryesore që bëhen në prona publike. Ka edhe raste individuale që marrin leje nga KRU Gjakova për çasje.

Defrim Kafexhiu: Po e nxëmë që një shtëpi është ndërtuar në një tokë bujqësore dhe kyçet në rrjetin e kanalizimi, çfarë masa merren nga drejtoria e Shërbimeve Publike?

Përparim Krasniqi: Nëse është pa leje, atëherë inspektorati shkon e dënon. Drejtoria e Shërbimeve Publike është investuese.

Kryesuesi: Faleminderit! A ka dikush tjetër diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, po e vendosi në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht aprovohet pika e dytë.

3. Shqyrtimi i Planit të Punës i Komitetit për Komunitete për vitin 2026:

Genta Morina: Të nderuar anëtarë të Komitetit për Politikë dhe Financa. Dua t'ju prezantoj shkurtimisht planin e punës së Komitetit për Komunitete për vitin 2026. Komiteti është themeluar tashmë rishtazi. Planin e punës e keni para vetës, plan ky që fokusohet në punën e promovimit të të drejtave të komunitetit joshumicë në komunën e Rahovecit, gjithnjë në bashkëpunim me Zyrën Komunale për Komunitete dhe Kthim. Plani, gjithashtu parasheh takime të rregullta dhe ftesë për drejtori komunale. Pjesë e planit është edhe promovimi i përdorimit të gjuhëve zyrtare.


Kryesuesi: Faleminderit, kryesuese! A ka dikush tjetër diçka rreth kësaj pike?... Nëse jo, ju njoftoj që ky plan i punës ka kaluar në Komitet për Komunitete dhe tani proceduralisht duhet të cedohet edhe në kuvend. Po e vendosi në votim. Kush është "për"?... Kundër?... Abstenim?... Unanimisht miratohet edhe pika e tretë e rendit të ditës.

4. Të ndryshme:

Defrim Kafexhiu: Nuk kam diçka, veçse të gjithë atyre që janë në garë në këto zgjedhje nacionale, ju uroj suksese, duke e përfshirë kryesuesin e kuvendit, nënkryetarin, shefin e grupit dhe Sarandë Salltekun.

Kryesuesi: Urimet i bashkohet edhe drejtori i Shëndetësisë, si dhe kolegja jonë Vlora Vuçiterna – Çmega. Nëse dikush tjetër ka diçka për të thënë?... Nëse jo, atëherë ju njoftoj që për mbledhjen e rregullt të kuvendit do t'i kemi edhe këto pika shtesë, që janë në interes që t'i kemi në seancë të kuvendit: 1. Plotësim-ndyshimi i Rregullores për Shërbime Publike; 2. Vendim për formimin e komisionit për shqyrtimin e ankesave për Këshillin e Fshatit Hoçë e Madhe; 3. Vendim për emërimin e komisionit për udhëheqjen dhe koordinimin e punës në terren për zgjedhjen e këshillave lokalë; 4. Vendimi për formimin e komisionit për emërimin të ankesave për procesin e zgjedhjes së kishillave lokalë; 5. Vendimi për formimin e komisionit për emërtimin dhe riemërtimin e rrugëve dhe rrugicave në komunën e Rahovecit; 6. Informatë nga Drejtoria për Bujqësi rreth rregullimit të rrugëve në komunën e Rahovecit për vitin 2025. Ju falënderoj për vëmendjen dhe shihemi në seancën e kuvendit.

Procesmbajtësi


Albjon Krasniqi



KRYESUESI


Fatmir Iska